



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Nr.398/1Prot.

Shkodër, më 21.01.2019

Lënda: Jepet informacioni i kërkuar

Rruga: _____

Në vijim të kërkesës suaj Nr. 2, datë 10. 01. 2019, regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr. 398, datë 10. 01. 2019, në të cilën, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit, ju informojmë si më poshtë:

Qendrat Komunitare “Për Familjen” të krijuara dhe vëna në funksion nga Bashkia e Shkodrës ofrojnë shërbime të qëndrueshme, të konsoliduara për komunitetin dhe kategoritë vulnerabël e në vështirësi. Gjatë situatës së krijuar për shkak të reshjeve të dëborës, për komunitetet më vulnerabël janë shpërndarë pako me ndihma ushqimore në komunitet dhe pranë qendrave komunitare. Edhe gjatë kësaj periudhe, ashtu si gjatë të gjithë vitit, në qendrat komunitare janë ofruar vakti ushqimor, është siguruar transporti për fëmijët rom, janë zhvilluar klasat passhkollore, etj.

Gjithashtu duhet të theksojmë se çdo qendër komunitare ka qenë në gadishmëri të plotë për strehim emergjent për fëmijët apo familjet në rrezik. Situata ka qenë në monitorim në vazhdimësi nga skuadrat e terrenit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETAR

Voltana Ademi
